



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINË

Numri i lëndës: 2023:050007

Datë: 12.12.2024

Numri i dokumentit: 06590858

C.nr.941/23

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË- Departamenti i Përgjithshëm Divizioni Civil, gjyqtarja Albana Çeku, në çështjen juridike-kontestimore, sipas padisë së paditëses D.P, e përfaqësuar sipas autorizimit nga Shoqëria e Avokatëve, ..., me seli në ..., kundër të paditurës Komuna e Prishtinës, Drejtoria Komunale e Arsimit (DKA) në Prishtinë, me objekt kontesti, kompensimin e shujtave (ushqimit), me datë 12.12.2024 mori këtë:

A K T V E N D I M

KONSTATOHET E TËRHEQUR, padia e evidentuar me numër të lëndës C.nr. 941/23, e datës 24.02.2023, e paraqitur nga paditësi D.P, kundër të paditurës Komuna e Prishtinës, Drejtoria Komunale e Arsimit në Prishtinë, me objekt kontesti, kompensimin e shujtave (ushqimit).

A r s y e t i m

Paditësja në këtë gjykatë, duke vepruar nëpërmjet përfaqësuesit të autorizuar ka paraqitur padi kundër të paditurës Komuna e Prishtinës, Drejtoria Komunale e Arsimit në Prishtinë, me objekt kontesti, kompensimin e shujtave (ushqimit).

Me datën 14.11.2024 përfaqësuesi i autorizuar i paditëses, ka dorëzuar në gjykatë një parashtresë në të cilën ka theksuar se e njofton Gjykatën se lidhur me këtë çështje juridike –kontestimore për kompensimin e shujtave (ushqimit) TERHIQET, sepse paditësja është kompensuar për këtë çështje.

Në lidhje me këtë, duke u bazuar në Ligjin 03/L-006 për Procedurën Kontestimore, dhe Ligjin Nr.04/L-188 për Ndryshimin dhe e Plotësimin e Ligjit 03/L-006, përkatësisht në neni 261, paragrafi 3, shprehimisht është përcaktuar se; *“po që se padia është tërhequr, gjykata jep aktvendim me të cilin konstatohet se është tërhequr padia. Ky aktvendim i dërgohet të paditurit vetëm po që se padia i është dorëzuar më parë.”*

Nga sa u tha më lartë, gjykata, në bazë të nenit 261, paragrafi 3, të LPK-së, e konstatoi të tërhequr padinë e paditësit, ashtu siç është vendosur në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil
C.nr.941/23 datë 12.12.2024

G j y q t a r j a
Albana Çeku

KËSHILLË JURIDIKE:

Bazuar në nenin 261, paragrafin 4, të LPK-së, kundër këtij Aktvendimi nuk lejohet ankesa.